



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**



N.T.SH. "VALANET"  
Nr. i biznesit 71001075  
Pronar – Besim GRULAJ  
OK "N.T.SH. VALANET"  
Qendra Zejtare Nr.1  
Therandë  
Ref: 1312/1735/KPM/ni

## VENDIM

*për licencimin e operatorit kabllorë, N.T.SH. "VALANET"- Therandë*

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllorë kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
3. Kandidati për operatorë kabllorë N.T.SH. "VALANET" ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë kabllorë më datën 11 nëntor 2013.
4. Në bazë të udhimit të KPM-së, të datës 15 maj 2014, për plotësim të kërkesës me dokumentet përkatëse, kandidati për licencë të KPM-së N.T.SH. "VALANET" më 27 maj 2014, ka dorzuar materialet shtesë duke vepruar në pajtim të plotë me udhëzimin e KPM-së.

### Arsyetim

5. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

6. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: “për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”.
7. KPM vlerëson se, kandidati N.T.SH. “VALANET” ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operatorë kabllorë, në pajtueshmëri me Nenin 7 të Rregullores për Distribuimin Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC 2007/04.
8. Me Rregulloren CIMC 2007/04 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operatorë kabllorë. Prandaj, Komisioni i KPM-së, vlerëson se një operatorë kabllorë mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve.
9. Kandidati për operatorë kabllorë N.T.SH. “VALANET” do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij programore, vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllorë.
10. Nëse, pas marrjes së licencës, kandidati për operatorë kabllorë N.T.SH. “VALANET” siguron marrëveshje shtese apo të reja për ritransmetimin e programeve në rrjetin kabllorë, KPM, pas pranimit të kontratave të reja, do të zgjerojë listën e programeve të kandidatit. Kandidati N.T.SH. “VALANET” obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja, sapo t’i ketë siguruar ato.
11. KPM vlerëson se N.T.SH. “VALANET” ka paraqitur aplikacionin në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me Rregulloren e KPM-së për Dhënien e Licencës (KPM-2013/04).
12. KPM vlerëson se, në bazë të nenit 7 të Rregullores CIMC 2007/04 kandidati për operatorë kabllorë N.T.SH. “VALANET” ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

### VENDIM

13. KPM merr vendim që kandidatit të interesuar për licencë të operatorit kabllorë N.T.SH. “VALANET” i cili planifikon të operojë në disa fshatra të Komunës së Therandës, t’i lëshoj licencën e KPM-së për Operatorë Kabllorë, për të ofruar shërbime të programeve përmes rrjetit kabllorë.

### Lëshimi i Vendimit

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.

  
Adnan MEROVCI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave

11.06.2014  
datë